

INSPEKTORATI SHITËTËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL						
Regjistri i Kërkesave/Ankesave dhe Përgjigjeve ISHTI DHJETOR 2025						
Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e Përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	09.12.2025	Kërkohej informacion mbi një bombul gazi që mban rreth 500 liter gaz, të cilën fqinja ime e përdor për ngrohjen e shtëpisë dhe e ka vendosur afër murit të banesës time. Shpresojmë që të merret në konsiderat ankesa pasi po bëhet viti që shkojmë sa të policia të zjarrfiksjë dhe të bashkia.	12.12.2025	Në përgjigje të ankesës tuaj, me email Nr.12239 Prot, datë 09.12.2025, ju bëjmë me dije se u ushtrua kontroll nga Inspektorët e Inspektoratit Shitëtaror Teknik Industrial pranë personit për të cilin ju ankoheni, ku u konstatua se ky person kishte të instaluar pajisje nën presion, depozitë GLN-500 Litra për të cilën disponon dokumentacionin tekniko-ligjor si më poshtë vijon; Dëshmi Afësie e Qytetarit për përdorimin e pajisjeve nën presion të lëshuara nga OMI "ECIT" SH.P.K. me Nr. 007 datë 05.06.2024. Kontratë për Furnizimi datë 19.12.2025. Certifikatat e konformitetit të inspektimit rezervuarit GLN lëshuar nga OMI 005-ST2 SH.P.K më datë 18/12/2025. Gjithashtu, depozita GLN është objekt i kolaudimit teknik periodik, i kryer nga trupa inspektuese të autorizuar dhe të miratuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas kërkesave të parashikuara nga ligji, për pajisjet nën presion. Përsa më sipër qytetari disponon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjorë për përdorimin e pajiseve nën presion si dhe kjo pajisje (PNP) plotëson kushtet thelbësore të sigurisë në zbatim të Ligjit 32 datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës së paisjeve dhe instalimeve nën presion".	E plotë	0
2	09.12.2025	Përmes këtij e-maili dua t'ju informoj për një situatë në biznesin fabrike prodhimi përbën rrezik serioz për sigurinë fizike të punonjësve dhe kërkon ndërhyrjen tuaj të menjëhershme. Bëhet fjalë për instalimin e një makineri e cila është vendosur në kushte të papërshtatshme teknike dhe pa praninë e specialistëve përkatës. Instalimi i makinerisë pa kontroll teknik profesional sipas informacionit , kjo makineri është instaluar pa mbikëqyrjen e një inxhinieri mekanik, elektrik apo industrial të licencuar. Ka dyshime se instalimi është kryer nga persona të pa kualifikuar për këtë lloj pajisjeje. Në këto rrethana, kërkohej verifikimi i plotë nëse makineria është vendosur sipas standardeve të sigurisë teknike, si dhe nëse plotëson kërkesat e legjislacionit për pajisjet me rrezik potencial për jetën. Mungesa e certifikimeve dhe dokumentacionit teknik për këtë makineri, ende pa certifikim ose kontroll teknik të kryer nga specialistë të fushës, lind dyshimi se ajo mund të jetë e pa testuar, e pa protokolluar dhe e pa pajisur me dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjor. Mungesa e këtyre elementëve e bën pajisjen një rrezik potencial të menjëhershëm gjatë operimit	19.12.2025	Në përgjigje të ankesës tuaj, e ridërguar me email Nr.12240 Prot, datë 09.12.2025, ju bëjmë me dije se subjekti është Inspektuar nga inspektorët e ISHTI-it në zbatim të Autorizimit Nr. 5334 Prot, datë 01.07.2025. Nga inspektimi i kryer pranë këtij subjekti, u konstatuar se ky subjekt për nevoja teknologjike kishte të instaluar pajisje nën presion, për të cilat disponon dokumentacionin tekniko-ligjor si më poshtë vijon; Dy Projekte Teknologjike të implantit të furnizimit me ajër të ngjeshur dhe implantit të furnizimit me GLN të kaldajave për prodhimin e ujit të ngrohtë të cilat janë hartuar nga Ing. Harens Ruli, Nr. Lic. 95. Vlerësimet e Konformiteteve të këtyre projekteve teknologjike, të kryera nga OMI 009-R2, ERGI-PINK SH.P.K me certifikata konformiteti të lëshuara me datë 02.03.2022, Nr. Serial: 0273; 0274. Aktet Teknike të montimit të lëshuara nga Ing. Harens Ruli, Nr. Lic. 95 dhe Ing. Megli Sinaj, Nr. Lic. N7258. Dëshmi Afësie të punojësit për përdorimin e pajisjeve nën presion të lëshuara nga OMI "ECIT" SH.P.K. me Nr. 25071, Nr. 25072 datë 04.03.2022, "AQScert", me Nr. Certifikatë AQ5/T/S91362022 më datë 28.01.2022 dhe Nr. AQ5/CK/S140012025 më datë 10.06.2025. Kontratë për sigurimin e përgjegjësisë civile ndaj palëve të treta, lëshuara nga "ATLANTIK"SH.A me Nr.120015920196440 dhe Nr.120015920196436 datë 19.06.2025; Nr.120015920195930 dhe Nr.120015920195931 datë 05.03.2025. Certifikatat e konformitetit të inspektimit teknik periodik të pajisjeve të lëshuara nga OMI "EPAS CERIFY" SH.P.K me Nr. E-ENP-24/0001 më datë 11.12.2024; OMI "ERGI-PINK" SH.P.K me NS-0053 më datë 01.02.2025; OMI "M.F.M. " SH.P.K. me Nr. 01770178 më datë 19.06.2025. Përsa më sipër subjekti dispononte të gjithë dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjorë për përdorimin e pajiseve nën presion si dhe këto pajisje (PNP) plotësojnë kushtet thelbësore të sigurisë në zbatim të Ligjit 32 datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës së paisjeve dhe instalimeve nën presion".	E plotë	0
3	11.12.2025	Kërkoj të pajisem me vërtetimin që dëshmon se subjekti ka treguar karburante sipas standardeve të legjislacionit dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë gjatë vitit 2025.Ky dokument kërkohej si dokument zyrtar për procedura administrative të subjekti	11.12.2025	Në lidhje me kërkesën tuaj për pajisje me vërtetim ju bëjmë me dije se në zbatim të Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik, aplikimi kryhet vetëm përmes platformës e-Albania.	E plotë	0
4	16.12.2025	Kërkesë për asistencë në kuadër të një kontrolli për matje me të specializuara në një subjekt që po inspektohet.	16.12.2025	Në përgjigje të kërkesës Tuaj me email me datë 16.12.2025, ku kërkohej asistencë për matje të specializuara në subjektin ju informojmë: Inspektorati Shitëtaror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është krijuar me VKM nr. 410, datë 13.5.2015, si institucion qëndror publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë Përgjegjëse për Hidrokarburet sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me kompetenca inspektimi në fushën energjitiko-industriale, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të dispozitave të kuartrit ligjor në fuqi: ligjit nr. 99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar; ligjit nr 32/2016 datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion"; ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike" i ndryshuar; si dhe të gjitha akteve nënligjore që rrjedhin prej tyre. Për sa më sipër ISHTI është organ inspektues sipas kuartrit ligjor të sipërcituar dhe nuk bën matje të specializuara, pasi kjo detyrë nuk përfshihet në detyrat ligjore. Faleminderit për bashkëpunimin.	E plotë	0